



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 277/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Remzi Thaçit komisioner nga radhët e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Gjakovë, për shkak të kërcënimit të bërë ndaj tij nëpërmes telefonit nga persona të panjohur, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 08.06.2014 aktivistin dhe komisionarin e LVV-së Remzi Thaçi nga qendra në Gjakovë rreth orës 3:45 persona të panjohur e kanë kërcënuar përmes telefonit që të mos vazhdoj ta përkrah LVV-në. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se ndaj komisionarit të LVV-së është kryer vepra penale e kërcënimit, dhe se në ankesën në fjalë është shënuar numri i tel. të kërcënuesit.

PZAP-i lidhur rastin në fjalë njoftoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi që të ndërmer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të identifikimit të kryesve të supozuar.

Në përgjigjen e dhënë nga policia e Kosovës thuhet se Policia e Kosovës në bashkëpunim me kryeprokuroren e Prokurorisë së Gjakovës kanë trajtuar çdo informatë që i është raportuar apo që janë vënë në dijeni dhe se sa i përket rastit në fjalë policia e Kosovës nuk ka qenë në dijeni dhe nuk është raportuar diçka e tillë, por se rastin në fjalë do ta trajtojnë duke e iniciuar si rast penal.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i pasi vlerësoi ankesën dhe shkresat e lëndës gjeti se e njëjta është e pabazuar, ngase nga ankesa në fjalë dhe nga raporti i policisë, nuk rezulton identiteti i personit që e ka kërcënuar komisionarin e LVV-së Remzi Thaçi. Ashtu siç shihet edhe nga raporti i policisë, Prokuroria e Gjakovës në bashkëpunim me policinë e Kosovës për rastin në fjalë do të hap rast penal. Prandaj PZAP-i mbi këtë bazë, duke pasur parasysh se nga kjo ankesë nuk është arritur që të argumentohet me ndonjë fakt identiteti i kryesit të supozuar të shkeljes , gjeti se kjo ankesë është e pa bazuar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 277/2014 më datën 12.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*